

UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
"HASAN PRISHTINA"  
FAKULTETI I EDUKIMIT FIZIK DHE I SPORTIT



**TEMA E MASTERIT**

**NDIKIMI I DIMENSIONEVE LONGITUDINALE ANTROPOMETRIKE  
TË DISA TESTEVE MOTORIKE NË KËRCIM SË GJATI TEK  
STUDENTËT E FEFS**

**MENTORI:**  
Prof.Dr.Naser Rashiti

**KANDIDATI:**  
Shkelqim Shabani

Prishtinë, 2019

## **PËRMBAJTJA**

<i>1. HYRJE</i> .....	3
<i>2. HULUMTIMET E DERITANISHME</i> .....	5
<i>3. QËLLIMI I HULUMTIMIT</i> .....	8
<i>3.1 HIPOTEZAT E HULUMTIMIT</i> .....	9
<i>4. METODAT E HULUMTIMIT</i> .....	10
<i>4.1 MOSTRAT E ENTITETEVE</i> .....	10
<i>4.2.1 MOSTRA E NDRYSHOREVE ANTROPOMETRIKE</i> .....	10
<i>4.2.2 MOSTRA E NDRYSHOREVE LËVIZORE</i> .....	11
<i>5. METODOLOGJIA E PUNËS</i> .....	12
<i>5.1 MOSTRA E TË TESTUARVE</i> .....	12
<i>5.2 PËRSHKRIMI I INSTRUMENTEVE MATËSE ANTROPOMETRIKE DHE SPECIFIKE-MOTORIKE</i> .....	13
<i>5.3 TEKNIKAT E MATJES</i> .....	13
<i>5. METODAT PËR PËRPUNIMIN E REZULTATEVE</i> .....	26
<i>6. INTERPRETIMI I REZULTATEVE DHE DISKUTIMI</i> .....	27
<i>6.1 TREGUESIT THEMELOR STATISTIKOR</i> .....	27
<i>6.2 ANALIZA REGRESIVE E PARAMETRAVE ANTROPOMETRIK DHE MOTORIK SI DHE SPECIFIKE – MOTORIKE</i> .....	39
<i>7. REZULTATET E NDËRLIDHJEVE</i> .....	39
<i>8. VËRTETIMI I HIPOTEZAVE</i> .....	47
<i>9. PËRFUNDIMI</i> .....	48
<i>10. LITERATURA</i> .....	50

## 1. HYRJE

Atletika është një lloj sporti aplikativ, i përbërë nga 5 grupe kryesore si: ecja sportive, vrapimet, kërcimet, hedhjet dhe shumë garëshet. Atletika funksionon mbi bazën e një sistemi të caktuar të dijeve dhe të shprehive aplikative praktike, që ka në përmbajtjen e saj bazat teorike e metodologjike të mësim-dhënies dhe të stërvitjes sportive. Fjala “Atletikë” rrjedh nga greqishtja e lashtë “Athla”, që do të thotë garë nëpërmjet ushtrimit. Në Greqinë e Vjetër, atletë quheshin të gjithë sportistët që mateshin me ushtrimet e forcës, të shpejtësisë, të shkathtësisë dhe të qëndrueshmërisë. E ndërsa në kohët moderne, “atlet” quhet sportisti i specializuar, që ushtrohet sistematikisht dhe merr pjesë aktive në gara të llojeve të ndryshme atletikore për rritjen e cilësisë sportive. Kërcimet atletikore janë ushtrime, që karakterizohen nga një fazë e zgjatur pa mbështetje, si pasojë e vrullit dhe rrahjes energjike mbi truall me njërën këmbë. Këto lloj ushtrimesh shoqërohen me sforcime të mëdha nervomuskulare, brenda një kohe të shkurtër. Si të tilla ato zhvillojnë me përparësi forcën shpërthyesë dhe shpejtësinë si dhe ndjesitë e të orientuarit në hapësirë dhe në kohë. Kërcimet atletikore ndahen në dy nëngrupe:

Kërcimet në lartësi ( kërcimet në lartësi, pa dhe me shkop)

Kërcime në gjatësi ( kërcimi së gjati, kërcimi 3-hapësh)

Në kërcimet në lartësi shtrohen kërkesa për zhvendosjen e QPR sa më lartë, ndërsa në kërcimet në gjatësi shtrohen kërkesa për zhvendosjen e QPR sa më larg.


Kërcimet atletikore zhvillohen në mjedise të posaçme.

Kështu psh: kërcimet së gjati zhvillohen në pistën e vrullit dhe në gropën e rërës. Kërcimet së larti zhvillohen në pistën e vrullit dhe në dyshekët e rënies pas kalimit të thuprës. Atletika është një nga llojet e sportit, me karakter kompleks dhe aplikativ, i përbërë nga grupe të mëdha, në të cilët përfshihen lloje të ndryshme atletikore, me karakteristika të ngjashme ndërmjet tyre. Përcaktimi i këtyre grupeve atletikore bëhet në mbështetje mbi disa kritere: kërkesat ndaj cilësive fizike ,mënyra e bashkërendimit të fazave teknike, mënyra e zhvillimit të llojit atletikor. Dukuritë lëvizore janë në vartësi të ndikimit të shumë faktorëve, jo vetëm të natyrës motorike dhe teknike, por edhe atyre morfologjike, funksionale, sociale dhe psikologjike, të cilët i japin asaj karakteristikat e duhura sasiore dhe cilësore, në hapësira të pakufizuara dhe shumëdimensionale, që ndryshe quhen hapësira manifestuese motorike. Klasifikimi dhe përcaktimi i saktë i këtyre hapësirave edhe sot, paraqitet si një proces i vështirë, të cilit i janë kushtuar mjaft studime specifike. Qëllimi kryesor i të cilëve është i orientuar kryesisht në

zbulimin e lidhjeve ndërmjetaftësive motorike dhe aspekteve të tjera të personalitetit të njeriut gjatë veprimeve të organizuara dhe pikësnyimeve, duke pasur për bazë përvojat empirike si dhe përjasjet shkencore në fushat fenomenologjike dhe funksionale të dukurive lëvizore. Vrapimet, si dhe kërcimet e ndryshme, janë forma natyrale të lëvizjes, në tërësi, dhe asaj atletike, në veçanti. Këto lëvizje përbëjnë një nga mjetet bazë të përgatitjes së gjithanshme të njeriut me pikësynim për arritje të larta sportive. Disiplinat atletike: vrapimet e shkurtra dhe kërcimet, japin një ndikim të madh në zhvillimin fizik dhe koordinimit, vetëm atëherë kur ato bashkërendohen me një shumëllojshmëri ushtrimesh të karakterit të përgjithshëm, mbi bazën e kombinimit adekuat të detyrave si dhe ngarkesës stërvitore, në kuadrin e mësimëve stërvitore.

**Struktura lëvizore e të gjitha kërcimeve ndahet kushtimisht në disa faza:**

**1. vrulli-            2. rrahja -            3. fluturimi    dhe 4. rënia**



## 2. HULUMTIMET E DERITANISHME

Kohëve të fundit është në rritje numri i punimeve nga autorë të ndryshëm në trajnimin e hapësirës së aftësive motorike në popullatën e të rinjve të moshave të ndryshme. Me **dimensione motorike\*** nënkuptojmë ato aftësi të njeriut të cilat marrin pjesë në kryerjen e detyrave motorike dhe kushtëzojnë lëvizje të suksesshme, pa marrë parasysh se a janë fituar aftësitë me anë të stërvitjes apo jo. Në nivelin e tashëm të njohjes së shkencës në këtë hapësi vërehet se dimensionet motorike në shumë hulumtime lajmërohen në mënyra të caktuara me detyra të ndryshme. Me aplikimin e analizës faktoriale zbulohen gjithnjë e më shumë faktorë motorik. Në trevat tona hulumtimet në popullatat e të rinjve, pavarësisht nga tretmani kineziologjik është ende i vogël, e në shumicën e hulumtimeve deri më tani kjo problematikë është trajtuar në mënyrë segmentare. Hulumtimet e kohës së fundit në hapësirën morfologjike flasin për ekzistimin e së paku katër dimensioneve latente: dimensionin e rritjes longitudinale të skeletit, dimensionin e rritjes transversale të skeletit, dimensionin e masës dhe vëllimit të trupit dhe dimensionin e indit dhjamor nënlekuror të trupit. Hulumtimet në trevën tonë janë orientuar më tepër në fushat e morfologjisë dhe motorikes, ku kanë shqyrtuar strukturën faktoriale, lidhshmëritë dhe ndikimet e këtyre fushave me dukuritë e sportive të ndryshme. Në shumë hulumtime të deritashme, në mostra të popullatës shkollore, është vërtetuar ekzistimi i dimensioneve antropometrike dhe motorike, por që ato ndryshojnë në varshmëri nga mostrat përkatëse. Në dy dekadat e fundit ekziston një numër relativisht i madh i eksperimenteve me nxënës të grupmoshave të ndryshme, sidomos të atyre prej 10 – 14 vjeç. Megjithatë, në bazë të literaturës që kanë shfrytëzuar, në vijim do të përshkruajmë disa hulumtime të cilat si objekt studimi kanë pasur vërtetimin e karakteristikave morfologjike si dhe relacionet e tyre me aftësitë motorike të nxënësve në mostra përafërsisht të njëjta, me mostrën e këtij hulumtimi.: Në hulumtimin e një grupi autorësh (1971), në mostrën prej 6330 nxënësve të të dy gjinive, të grupmoshave prej 11 – 17 vjeç, kanë aplikuar 18 variabla antropometrike dhe 36 motorike. Në submostrën e grupmoshave prej 11 – 15 vjeç, kanë vërtetuar faktorizimin e dy

---

\*Me nocionin dimensione motorike nënkuptohen ato aftësi motorike (abilites), të cilat më herët (kah fundi i shek. XIX dhe fillimi i shek. XX) janë quajtur »aftësi fizike» e më vonë »cilësi fizike», »kualitete lëvizore» e tjera.

dimensioneve latente në hapësirën antropometrike të definuar me faktorin e masës dhe vëllimit me indin dhjamor nënlëkuror, dhe faktorin dimensional longitudinal me atë transversal të skeletit.

M. Aliu (1974), në mostrën e entiteteve të moshës 15 – 17 vjeç, me anë të 18 variablave të trajtuara ka caktuar statusin antropometrik, me ç'rast ka ekstraduar tri dimensione latente: dimensionin i parë është identifikuar si dimensionin qarkor i skeletit, i dyti si faktor i indit dhjamor nënlëkuror dhe faktori i tretë si faktori transversal i skeletit.

F. Cankar (1995), në mostrën prej 485 nxënësve të moshës 13 – 14 vjeç, ka vërtetuar lidhshmërinë ndërmjet dimensioneve motorike të femrave dhe meshkujve me dimensionet të cilat e determinojnë punën dhe aktivitetin edukativ-pedagogjik të mësuesve të edukimit fizik. Në bazë të rezultateve të punimit, autori ka vërtetuar se përmbajtjet programore të lëndës së edukimit fizik, i janë përshtatur më shumë meshkujve se femrave.

A. Kasa (2001), në eksperimentin me fëmijët e moshës 10 – 14 vjeç, nga Tirana (meshkuj dhe femra), analizon gjendjen e aftësive të përgjithshme motorike dhe bën krahasimin e tyre me moshatarët e vendeve tjera. Në bazë të rezultateve të eksperimentit ka rezultuar se fëmijët tanë janë në të njëjtin nivel me ata të vendeve tjera, në shumicën e elementeve psikofizike, me një ngecje të theksuar në rregullimin struktural të lëvizjeve, respektivisht në testet e koordinimit.

**Rashiti (2011)** në hulumtimin e tij ku janë përfshirë 173 nxënës të dy gjinive të ndarë në grupe të barabarta që pa pasur qëllim përcaktimin e lidhshmërisë ndërmjet aftësive motorike dhe disiplinave të atletikës në distanca të shkurtra dhe të mesme si dhe ndikimin e vrapimeve në distanca të ndryshme. Autori ka arritur në përfundim se rezultatet e firmuara tregojnë për ekzistimin e ndikimit mesatar të variablave motorike në vrapimin 1000 metra. Punimet në këtë sub hapësirë kryesisht janë parciaisht, me numër të vogël mostrash dhe të variablave. Studimi i kësaj problematike ka për qëllim njohjen sa më të mirë të faktorëve të ndryshëm të zhvillimit morfologjik, dhe motorik në përcaktimin dhe njohjen sa më të mirë në realizimin e suksesshëm të teknikës së shtytjes së gjyles. Njëkohësisht, ky dhe hulumtimet e tilla duhet të paraqesin nxitje në përpjekjet e mëtutjeshme të studimeve të ardhshme në këtë hapësirë. Duke e zhvilluar punën hulumtuese në një nivel më të lartë dhe hapësirë më të gjerë mund të priten gjithmonë njohuri të

plota dhe complete. Në këtë rrugë, shpresojmë se edhe ky punim do të paraqes një nga shkallët e zhvillimit.

**Baftiu (2018)** thekson se hulumtimi është zbatuar me qëllim të përcaktimit të dallimit të disa karakteristikave antropometrike, motorike dhe specifiko-motorike në mes të nxënësve të viseve urbane dhe nxënësve të viseve rurale të moshës 15 vjeçare. Në mostër janë përfshirë 60 nxënës të viseve urbane dhe 60 nxënës të viseve rurale, të përfshirë në seksionin e atletikës në kuadër të shkollës dhe 60 nxënës që përpos orëve të rregullta të edukatës fizike nuk janë marrë me ndonjë aktivitet sportiv. Gjithsej në hulumtim janë përfshirë 120 nxënës) që janë testuar gjatë periudhës kohore shkollore shtator të vitit 2018. Të gjitha variablat e përdorura antropometrike, motorike dhe specifike-motorike i'u janë nënshtruar përpunimeve themelore statistikore, në bazë të së cilës është vërtetuar se të gjitha testet kanë karakteristika metrike të kënaqshme. Dallimi në mes mesatareve aritmetikore të rezultateve të grupeve të hulumtuara është përcaktuar me anë të analizës diskriminative T-testit. Rezultatet e fituara nga përpunimi i tyre tregojnë se dallime të rëndësishme statistikore në mesataret aritmetikore në mes të nxënësve të viseve urbane dhe nxënësve të viseve rurale janë fituar në variablat: Gjatësia e krahut (AGJAKR) , Pesha e trupit (AGJAKR) Vrapimi 60 metra nga starti ulët (MV60SL), Vrapimi 80 metra nga starti ulët (MV80SL) Vrapimi 100 metra nga starti ulët (MV100SL). Mund të theksojmë se zhvillimi i shpejtësisë ose i vrapimeve në distanca të shkurtra është nën ndikimin e faktorit trashëgues, me ushtrime dhe procese stërvitore të organizuara mirë mund të ndikohet pozitivisht në rritjen e saj.

### 3. QËLLIMI I HULUMTIMIT

Në varësi nga numri i subjekteve të cilët do të trajtohen në këtë punim, moshë e tyre, tretmani i ndryshëm sa i përket zhvillimit të aftësive lëvizore si dhe aplikimit të variablave përmes së cilave do të testohen subjektet e këtij eksperimenti, qëllimet dhe objektivat kryesore në këtë projekt do të përkufizohen në realizimin e këtyre qëllimi:

- **Qëllimi bazik** i hulumtimit del nga lëmia dhe problemi i parashtruar i hulumtimit që është i orientuar në zbulimin e faktorëve morfologjik dhe motorik si dhe ndikimin të këtyre së bashku në ekzekutimin e detyrës teknike në atletikë, konkretisht në Kërcim së gjati tek studentët e vitit të parë dhe tretë të Fakultetit të Kulturës Fizike dhe Sportit.
- Ndikimi në relacionet ndërmjet aftësive lëvizore në statusin psikosomatik të trajtuar.

Duke u nisur nga qëndrimet e paraqitura në qasjen e problemit dhe lëndës së hulumtimit, qëllimi është të konstatohet gjendja e karakteristikave antropometrike dhe aftësive motorike të studentëve, të vërtetohet lidhshmëria e karakteristikave antropometrike, motorike dhe kriterike te studentët e vitit të parë dhe vitit të tretë të FKF dhe Sportit.



### **3.1. HIPOTEZAT E HULUMTIMIT**

Në bazë të lëmisë dhe problemit të hulumtimit dhe në përputhje me qëllimin dhe metodat statistikore për përpunimin e rezultateve formulohen dhe parashtrihen këto hipoteza:

**H<sub>01</sub>** – Distribucioni i fituar i variablave antropometrike, motorike dhe kriterike, të aplikuara në këtë punim nuk do të ketë shmangie nga distribucioni normal.

**H<sub>02</sub>** – Rezultatet e variablave antropometrike kanë koeficiente të korrelacionit statistikor të rëndësishme.

**H<sub>03</sub>** – Variablat antropometrike dhe motorike do të kenë ndikim statistikor të rëndësishme në realizimin e teknikës së kërcim së gjati.

## 4. METODAT E HULUMTIMIT

### 4.1. MOSTRAT E ENTITETEVE

Mostrat e të hulumtuarve përbëhet nga 95 studentë të gjinisë mashkullore të moshës  $19 \pm 6$  vjeçare, të cilët në mënyrë të rregullt kanë vijuar mësimindhe rregullisht kanë marrë pjesë në orët e atletikës. Në punim janë testuar studentët e vitit të parë, ku mosha e tyre sillet  $19 \text{ vjeç} \pm 6$  muaj. Të gjithë studentët të cilët kanë qenë të sëmurë dhe ata të cilët kanë munguar me rastin e realizimit në ndonjërin nga testet e punimit janë eliminuar nga hulumtimi.

Kriteret themelore për testimin e studentëve :

- a) ndryshimet në moshë të mos jenë më të mëdha se  $19 \pm 6$  muaj,
- b) gjatë vitit të kenë qenë të rregullt në procesin e rregullt mësimor,
- c) gjatë vitit të kenë qenë të rregullt në orët e lëndës e atletikës,
- ç) gjatë testimit të mos jenë të sëmurë,
- d) të mos kenë deformime të theksuara trupore apo fiziologjike.

#### 4.2.1 MOSTRA E NDRYSHOREVE ANTROPOMETRIKE

Testi morfologjik përmban këto tregues:

1.	Lartësia trupore	ALTR
2.	Pesha trupore	APESH
3.	Kërcim së larti nga vendi	MKLA
4.	Kërcim së gjati nga vendi	MKGJV
5.	Vrapim 20 metra starti lartë	V20M
6.	Zgjatje para në bankë	PPB

#### **4.2.2 MOSTRA E NDRYSHOREVE LËVIZORE**

Testi motorik përmban këto tregues:

7.	Kërcimi nga vendi me të djathtën	MKDV
8.	Kërcimi nga vendi me të majtën	MKMV
9.	Indi dhjamor nënlëkuror i barkut	ADHAB
10.	Indi dhjamor nën lëkuror i kofshës	ADHKO
11.	Kërcim së gjati me vrull	KGJVR

#### **4.2.3 MOSTRA E NDRYSHOREVE LËVIZORE-KRITERIKE**

Testi motorik-kriterike përmban këto tregues:

1	Kërcim së gjati me vrull	KGJVR
---	--------------------------	-------

## **5.METODOLOGJIA E PUNËS**

### **5.1 MOSTRA E TË TESTUARVE**

Në këtë punim janë përfshirë gjithësej 95 studentë të vitit të parë të moshës 19+-6 vjeçare gjatë kalendarit shkollor 2018/2019.

Mostrat e të testuarve është përbërë një i përbërë prej 95 studentë të FEF dhe Sportit.

Pasi, studentët kanë kaluar procedurën paraprake të përzgjedhjes me rastin e evidentimit, është e natyrshme se do të jenë të aftë në aspektin psikofizik që t'i nënshtrohen testeve të tilla për qëllimet e këtij punimi.

#### **Kriteri themelor për pjesëmarrje në hulumtim ka qenë:**

- a) që gjatë vitit të kenë qenë të rregullt në orët e edukatës fizike
- b) të kenë qenë të rregullt në procesin mësimor,
- c) të mos jenë të sëmurë gjatë testimit,

## 5.2 PËRSHKRIMI I INSTRUMENTEVE MATËSE ANTROPOMETRIKE DHE SPECIFIKE- MOTORIKE

### 5.3 TEKNIKAT E MATJES

#### 5.3.1 Teknika e matjeve të karakteristikave antropometrike

Variablat antropometrike janë matur sipas mënyrës siç vijon:


**1.Lartësia e trupit (ALARTË)** është matur me antropometër sipas Martinit. Gjatë matjes i testuari është i zbathur në brekë dhe qëndron në drejtqëndrim në bazën e rrafshët të antropometrit. Koka e të testuarit duhet të jetë në atë pozitë që drejtëza e Frankfurtit të jetë horizontale. I testuari drejton shpinën aq sa është e mundur, dhe shputat i ka të bashkuara. Testuesi qëndron nga ana e majtë dhe kontrollon se akrepi i antropometrit a është vendosur vertikalisht në mënyrë të drejtë drejtpërdrejt përgjatë pjesës së mbrapme të trupit të testuarit dhe pastaj, lëshon unazën metalike (rreshqitësin) ashtu që akrepi horizontal të vendoset në mënyrë të drejtë në majën e kokës. Atëherë lexohet rezultati në shkallën e matjes të antropometrit me saktësi prej 0,1 cm.

**Foto 1. Lartësia e trupit**



**2.Pesha e trupit (APESHA)** është matur me peshore transportabile të vendosur në sipërfaqe të rrafshët. I testuari, zbathur dhe në brekë vendoset në mesin e peshores dhe qëndron në drejtqëndrim. Atëherë kur akrepi në peshore nuk lëviz, rezultati lexohet me saktësi prej 0,5 kg.

*Foto 4. Pesha e trupit*



### 3.Kërcim së larti nga vendi – MKLART



**Instrumentet:** Metri metalik i vendosur në dy anët e murit për kërcim. Lartësia në mur është shënuar me cm deri mbi 3 m. lartësi.

#### **Përshkrimi i detyrës:**

**Pozita fillestare:** I testuari vendoset brinjazi pranë murit, shputat janë të vendosura në gjerësi të legenit. I testuari e ngrit dorën e cila është afër murit dhe me pëllëmbë të shtrirë maksimalisht , kurse testuesi regjistron lartësinë e prekjes së parë, i testuari kërcen vertikalisht në lartësi (tre tentime) lexohet rezultati më i mirë prej prekjes së parë deri në kërcimin maksimal,lexohet diferenca në cm.

**Realizimi i detyrës:** I testuari e ngrit dorën e cila është afër murit dhe me pëllëmbë të shtrirë maksimalisht, kurse testuesi regjistron lartësinë e prekjes së parë , i testuari kërcen vertikalisht në lartësi (tre tentime). Lexohet rezultati më i mirë prej prekjes së parë deri në kërcimin maksimal,lexohet diferenca në cm. Rezultati shënohet me 1 cm.

**Vlerësimi:** lexohet rezultati më i mirë prej prekjes së parë deri në kërcimin maksimal, lexohet diferenca në cm.

#### 4. Kërcim nga vendi në gjatësi – MKGJV

**Instrumentet:** Dysheku i gjimnastikës dhe metri metalik i vendosur në dy anët e vendit për kërcim.

**Përshkrimi i detyrës:**

**Pozita fillestare:** I testuari qëndron i kthyer me fytyrë kah drejtimi i kërcimit në pozitë drejt qëndrimi me këmbë të thyera në gjunjë që mundëson kërcim më të suksesshëm.

**Realizimi i detyrës:** I testuari kërcen tri herë, duke përsëritur kërcimet njërin pas tjetrit. Matet gjatësia e kërcimit prej vijës shtytëse e deri te gjurmët e shputave

(pjesa fundore). Rezultati shënohet me saktësi prej 1 cm.

**Vlerësimi:** Matet gjatësia e kërcimit prej vijës shtytëse e deri te gjurmët e shputave (pjesa fundore). Rezultati shënohet me saktësi prej 1 cm.





## **Kërcim nga vendi në gjatësi – MKGJV**

**Instrumentet:** Dysheku i gjimnastikës dhe metri metalik i vendosur në dy anët e vendit për kërcim.

### **Përshkrimi i detyrës:**

**Pozita fillestare:** I testuari qëndron e kthyer me fytyrë kah drejtimi i kërcimit në pozitë drejt-qëndrimi me këmbë të kthyer në gjunjë që mundëson kërcim më të suksesshëm.

**Realizimi i detyrës:** I testuari kërcen tri herë, duke përsëritur kërcimet njërin pas tjetrit. Matet gjatësia e kërcimit prej vijës shtytëse e deri te gjurmët e shputave (pjesa fundore). Rezultati shënohet me saktësi prej 1 cm.

**Vlerësimi:** Matet gjatësia e kërcimit prej vijës shtytëse e deri te gjurmët e shputave (pjesa fundore). Rezultati shënohet me saktësi prej 1 cm.

### **7. Kërcim së gjati nga vendi**



## 1. Vrapim 20 metra nga starti i lartë – MV20SU

**Instrumentet:** Kronometri me 1/10 sek.

**Përshkrimi i detyrës:**

**Pozita fillestare:** I testuari përgatitet për vrapim pranë vijës së startit, në pozitë të startit të lartë:

**Realizimi i detyrës:** I testuari pas sinjalit për nisje duhet të vrapoj me shpejtësi maksimale deri në vijën e caktuar, matet koha nga momenti i nisjes e deri në momentin kur i testuari me krahëror kalon rrafshin vertikal mbi vijën e caktuar.

**Vlerësimi:** Matet koha nga dhënja e sinjalit nga matësi ndihmës, deri në momentin kur i testuari kalon me trung vijën e paramenduar me vijën e caktuar. Koha matet në saktësi 1/10 sec.

**Udhëzime të testuarit:** Në rast të startit jo të rregullt, vrapimi përsëritet. Të testuarit udhëzohen që pas arritjes në vijën e caktuar të vazhdojnë vrapimin edhe për disa metra, duke u ndalur në mënyrë graduale.

*Foto 12. Vrapim 20 metra nga starti i ulët*



## **Fleksibiliteti në bankë (përkulje para) – PPB**

**Instrumentet:** Banak, metri milimetrik i plastikës e përforcuar për dërrasë të gjatë 80 cm dhe të gjerë 10 cm.

### **Përshkrimi i detyrës:**

**Pozita fillestare:** I testuari qëndron mbi ulësen suedeze, me këmbët drejtë, në përkulje të thellë të trupit dhe me fytyrë nga drejtimi i përkuljes.

**Realizimi i detyrës:** I testuari në përkulje të thellë dhe këmbët drejtë, në maje të gishtërinjve të të dy shuplakave të cilat janë paralelisht njëra me tjetrën, të prekin sa më thellë metrin. Detyra përsëritet dy herë. E testuara e mban pozitën e fundit që leximi të jetë sa më i saktë.

**Vlerësimi:** Shënohet rezultati i përkuljes më të thellë i shënuar me centimetra. Pika zero është në maje të centimetrave, saktësia e matjes 0,5 cm.

**Udhëzime të testuarës:** I testuari merr udhëzime gjatë demonstrimit të detyrës. I tregohet për pozitën e rregullta dhe ato të parregullta.

### **Foto 11. Përkulje para**



## **Kërcim nga vendi në gjatësi me të djathtën – MKDV**

**Instrumentet:** Dysheku i gjimnastikës dhe metri metalik i vendosur në dy anët e vendit për kërcim.

### **Përshkrimi i detyrës:**

**Pozita fillestare:** I testuari qëndron i kthyer me fytyrë kah drejtimi i kërcimit në pozitë drejtë qëndrimi me këmbë të thyera në gjunjë që mundëson kërcim më të suksesshëm.

**Realizimi i detyrës:** I testuari kërcen tri herë, duke përsëritur kërcimet njërin pas tjetrit. Matet gjatësia e kërcimit prej vijës shtytëse e deri te gjurmët e shputave

(pjesa fundore). Rezultati shënohet me saktësi prej 1 cm.

**Vlerësimi:** Matet gjatësia e kërcimit prej vijës shtytëse e deri te gjurmët e shputave (pjesa fundore). Rezultati shënohet me saktësi prej 1 cm.

### **8. Kërcim së gjati nga vendi me këmbën e djathtë**



### 3. Kërcim nga vendi në gjatësi me të majtën – MKMV

**Instrumentet:** Dysheku i gjimnastikës dhe metri metalik i vendosur në dy anët e vendit për kërcim.

#### **Përshkrimi i detyrës:**

**Pozita fillestare:** I testuari qëndron i kthyer me fytyrë kah drejtimi i kërcimit në pozitë drejtë qëndrimi me këmbë të thyera në gjunjë që mundëson kërcim më të suksesshëm.

**Realizimi i detyrës:** I testuari kërcen tri herë, duke përsëritur kërcimet njërin pas tjetrit. Matet gjatësia e kërcimit prej vijës shtytëse e deri te gjurmët e shputave

(pjesa fundore). Rezultati shënohet me saktësi prej 1 cm.

**Vlerësimi:** Matet gjatësia e kërcimit prej vijës shtytëse e deri te gjurmët e shputave (pjesa fundore). Rezultati shënohet me saktësi prej 1 cm.

#### **9. Kërcim së gjati nga vendi me këmbën e majtë**



**Indi dhjamor nënlëkuror i barkut** është matur me kaliper “John Bull” i rregulluar ashtu që shtypja e skajeve të krahve të kaliperit në lëkurë të jetë  $10\text{gr}/\text{mm}^2$ . Para matjes i testuari është i zbathur, në brekë dhe qëndron në drejtëqëndrim me duar të lëshuara nga poshtë dhe relaksim të muskujve të barkut. Testuesi me gishtin e madh dhe gishtin tregues të dorës së majtë horizontalisht kap lëkurën në anën e majtë të barkut në nivel të kërthizës (ombilikusit) dhe 5 cm në të majtë nga ai, duke pasur kujdes që të mos kap edhe inde muskulore , kap palën (rrudhën) me majet e akrepave të kaliperit(të vendosur medialisht nga majet e gishtrinjëve). Rezultati lexohet me saktësi prej 0,2 mm.



**Indi dhjamor nën lëkuror i kofshës** është matur me kaliper “John Bull” i rregulluar ashtu që shtypja e skajeve të krahëve të kaliperit në lëkurë të jetë 10gr/mm<sup>2</sup>. Para matjes i testuari është i zbathur, në brekë qëndron në drejtqëndrim me duar të lëshuara nga poshtë. Testuesi me gishtin e madh dhe gishtin tregues të dorës së majtë vertikalisht kap lëkurën drejtpërdrejt në pjesën e mbrapme të këmbës së majtë (tek muskuli biceps) në vendin e cila i përgjigjet mesit, duke patur kujdes që mos të kapet indi muskolor, kap palën (rrudhën) e lëkurës me majet e akrepave të kaliperit (të vendosur më poshtë se majet e gishtrinjëve. Rezultatet lexohen me saktësi prej 0,2 mm.



## **Kërcim së gjati me vrull KGJVR**

**Instrumentet:**Përgatitja e gropës së rërës për kërcim.

**Përshkrimi i detyrës:**

**Pozita fillestare:** I testuari qëndron i kthyer me fytyrë kah drejtimi i kërcimit së gjati me vrull në pozitë drejtë qëndrimi ideal për vrapim që mundëson kërcim më të suksesshëm në gropën e rërës.

**Realizimi i detyrës:**I testuari kërcen tri herë, duke përsëritur kërcimet njërin pas tjetrit. Matet gjatësia e kërcimit prej vijës shtytëse e deri te gjurmët e shputave.

(pjesa fundore). Rezultati shënohet me saktësi prej 1 cm.

**Vlerësimi:**Matet gjatësia e kërcimit prej vijës shtytëse e deri te gjurmët e shputave (pjesa fundore). Rezultati shënohet me saktësi prej 1 cm.

## **5. METODAT PËR PËRPUNIMIN E REZULTATEVE**

Në mënyrë qëkërkimi shkencortë jepzgjdhjetë kënaqshme, është e nevojshmeqë të përdorenprocedurat e duhura, të drejta dhe komperative e qëjanë të natyrës së atij problemi tëdhënë.



Duke marrë parasysh të gjithakëto fakte, për qëllimet e këtij hulumtimi janë zgjedhur procedurat për të cilat konsiderohet se korrespondojnë mënyrën e problemeve që hulumtohen.

Për çdo variabël antropometrike, janë llogaritur vlerat e mëposhtme:

### 1. Parametrat qendrore themelore të shpërndarjes:

- Mesatarja aritmetike (Ma)
- Devijimi standard (Ds)
- Vlera minimale (Min)
- Vlera maksimale (Max)

**2. Lakorja e distribucionit** ose eshpërndarjes së testuar me anë të koeficientit të asimetrisë („**skjunis**”), dhe shkalla e lakimit majës së kurbës së rezultateve të shpërndara (lartësia e distribucionit) përmes koeficientit të sheshtë („**kurtozis**”).

**3. Raportet e ndërlidhjeve** ndërmjet variablave në hapësirën manifeste, si dhe korrelacionet ndërmjet sistemit të variablave.

**4. Për përcaktimin** e relacionit ndërmjet variablave prediktore (karakteristikave antropometrike dhe motorike) dhe variablës kritere (kërcim së gjati me vull) është aplikuar **analiza regressive** në hapësirën manifeste.

## 6. INTERPRETIMI I REZULTATEVE DHE DISKUTIMI

### 6.1. TREGUESIT THEMELOR STATISTIKOR


#### 6.1.1 Treguesit themelor statistikor të parametrave antropometrik dhe motorik-specifik

Në tabelën 1 janë paraqitur parametrat themelor statistikor të parametrave antropometrik të studentët e moshës 19+–6 vjeçare, ku janë të paraqitura vlerësimet e mesatares aritmetike, rezultati

minimal, rezultati maksimal, devijimi standard, parametrat e shpërndarjes ose të asimetrisë (Skewness – anim, asimetri) dhe shkalla e shtrirjes së kulmit të lakores të distribucionit të rezultateve (Kurtosis – konveksitet).Tabela 1.


**Tabela 1. Parametrat themelore statistikore të ndryshoreve antropometrike, motorike bazike dhe motorike specifike te studentët e FEF dhe Sportit**

	N	Minimum	Maximum	Mean	Std. Deviation	Skewness	Kurtosis	KV
ALTR	95	168.70	188.60	178.5632	5.67456	.077	-1.164	3.178
APESH	95	71.20	77.80	75.5189	1.61820	-.928	.480	2.143
ADHAB	95	10.10	13.50	11.9632	.98554	-.326	-.934	8.238
ADHKO	95	11.20	24.20	15.3147	2.47678	.358	.427	16.173
MKLV	95	40.00	57.00	47.2105	4.40960	.003	-.868	9.340
MKGJV	95	2.20	2.82	2.4712	.18274	.158	-.953	7.395
MKDV	95	1.84	2.31	2.0995	.13837	-.348	-1.030	6.591
MKMV	95	1.85	2.22	2.0860	.11996	-.569	-.807	5.751
V20M	95	3.09	3.56	3.3187	.13909	.285	-1.282	4.191
PPB	95	10.00	18.00	13.4316	2.44798	.111	-1.116	18.226
KGJVR	95	4.59	5.60	5.0597	.32582	-.046	-1.493	6.440




Mesatarja aritmetikore e matjes të ndryshores antropometrike, Lartësia e trupit (**ALTR**) (Tabela 1 dhe Histogramet 1) është 178.02cm. Rezultati minimal i matjes (168.70cm) dhe atij maksimal (188.60cm) i ndryshores

antropometrike, Lartësia e trupit tregon se ekziston një dallim i theksuar në mes nxënësve në këtë ndryshore antropometrike. Rezultatet tregojnë për një anim të lehtë të vlerave të kësaj ndryshore kah vlerat më të larta, tregon sepse testi i asimetrisë është negative (hipokurtik). Studentët e moshës 19 +-6 vjeçe në bazë të vlerave të arritura në këtë ndryshore antropometrike paraqiten si grup homogjen (KV=3.07%) dhe me një distribucion që ka shmangie nga ai normal.



Mesatarja aritmetike e matjes të ndryshorës antropometrike, Peshë e trupit (**APESH**) (Tabela 1 Histogramet 2) është 75.28 kg. Rezultati minimal i matjes (64.80 kg) dhe atij maksimal (77.80 kg.) i ndryshorës antropometrike Peshë e trupit tregon se ekziston një


dallim i theksuar në mes nxënësve në këtë ndryshore antropometrike. Rezultatet tregojnë për një anim të lehtë të vlerave të kësaj ndryshore ka vlerat më të larta tregon sepse testi i asimetrisë është negative (hipokurtik). Studentët e moshës 19 +-6 vjeçe në bazë të vlerave të arritura në këtë ndryshore antropometrike paraqiten si grup mesatarrisht homogjen (KV=18.4%) dhe me një distribucion që nuk ka shmangie nga ai normal, djathtas përndarja asimetrike negative.



Mesatarja aritmetikore e vlerësimit të ndryshorës motorike bazike , Kërcim së larti nga vendi (MKLA) (Tabela 1 dhe Histogramet 7) është 47.28 Rezultati minimal i matjes (40.00 cm.) dhe atij maksimal (57.00) i ndryshorës motorike bazike Kërcim së gjati nga vendi tregon se ekziston një dallim i theksuar në mes nxënësve në këtë ndryshore antropometrike. Rezultatet tregojnë


për një anim të lehtë të vlerave të kësaj ndryshore kah vlerat më të ulëta tregon sepse testi i asimetrisë është pozitiv (epikurtik). Studentët e moshës 19 +-6 vjeçe në bazë të vlerave të

arritura në këtë ndryshore motorike bazike paraqiten si grup homogjen ( $KV=9.01\%$ ) dhe me një distribucion që ka shmangie nga ai normal, maje normale mezokurtoazise.




Mesatarja aritmetikore e vlerësimit të ndryshorës motorike bazike, Kërcim së gjati nga vendi me këmbën e djathtë (**MKGJV**) (Tabela 1 dhe Histogramet 4) është 2.47 cm. Rezultati minimal i matjes (2.20 cm) dhe atij maksimal (2.82 cm) i ndryshorës motorike bazike Kërcim së gjati nga vendi me këmbën e djathtë tregon se ekziston një

dallim i theksuar në mes nxënësve në këtë ndryshore antropometrike. Rezultatet tregojnë për një anim të lehtë të vlerave të kësaj ndryshore kah vlerat më të ulëta, tregon sepse testi i asimetrisë është pozitiv (epikurtik). Studentët e moshës 19 +-6 vjeçe në bazë të vlerave të arritura në këtë ndryshore motorike bazike paraqiten si grup homogjen ( $KV=10.74\%$ ) dhe me një distribucion që ka shmangie nga ai normal, maje normale mezokurtoazise.




Mesatarja aritmetikore e vlerësimit të ndryshorës motorike specifike, Vrapim 20 metra starti (V20M) (Tabela 1 dhe Histogramet 5) është 3.32 sek. Rezultati minimal i matjes (3.09sek) dhe atij maksimal (3.56 ndryshorës motorike specifike Vrapim 20 metra starti ulët tregon se ekziston një dallim i

theksuar në mes nxënësve në këtë ndryshore antropometrike. Rezultatet tregojnë për një anim të lehtë të vlerave të kësaj ndryshore kah vlerat më të ulëta tregon sepse testi i asimetrisë është pozitiv (epikurtik). Studentët e moshës 19 +/-6 vjeçe në bazë të vlerave të arritura në këtë ndryshore motorike bazike paraqiten si grup homogjen (KV=4.23%) dhe me një distribucion që ka shmangie nga ai normal, maje normale mezokurtoazise.



